

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË
TË SHTETIT PËR VITIN 2020**

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rolin e institucionit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,

Vlerëson veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2020 në drejtim të:

- Angazhimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për zhvillimin normal të veprimtarisë së institucionit, edhe pse në kushte të vështira të krijuara si pasojë e pandemisë Covid-19, i cili është pasqyruar në përfundimin e 73 auditimeve, të ushtruara në 91 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

- Adresimit të një numri total prej 1430 rekomandimesh të dhëna për institucionet publike të audituara, nga të cilat: 29 janë propozime për përmirësime ligjore, 1107 masa organizative dhe 294 rekomandime për masa disiplinore dhe administrative.

- Vijimit të punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare, me një dëm efektiv të përgjithshëm në shumën rreth 88 miliard lekë dhe ku shkeljet më të mëdha janë në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik.

- Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, duke paraqitur pranë organit të prokurorisë 8 kallëzime ose indicie penale për 12 drejtues të nivelit të lartë, të mesëm dhe specialist të administratës publike.

- Angazhimit maksimal në të qenit aktiv dhe produktiv në luftën kundër korrupsionit, duke përkrahur, mbështetur dhe duke u angazhuar në çdo iniciativë ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndjekjen e 95 proceseve gjyqësore, nga ku rezultojnë se gjykatat e shkallës së parë në 21 vendime të dhëna kanë konfirmuar rekomandimet e gjetura nga KLSH-ja në auditimet e zhvilluara.

- Miratimit të disa manualeve dhe rregulloreve të rëndësishme, ku përmenden Manuali i Auditimit Financiar, Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, Manuali i Auditimit të Performancës, në frymën e standardeve të INTOSAI-t “Korniza e standardeve profesionale INTOSAI”, Manualin e Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve, si dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit.

- Fuqizimit të rolit të KLSH-së në medien e shkruar nëpërmjet publikimit të 925 artikujve, si dhe rritjes së besueshmërisë së publikut nëpërmjet trajtimit të 301 letrave dhe ankesave, nga të cilat pjesa kryesore u adresohet problematikave që lidhen me privatizimin dhe kthimin e pronës, administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik.

- Modernizimit të aktivitetit auditues dhe trajnimit të audituesve të KLSH-së, të cilët në fund të vitit 2020 rezultojnë se kanë siguruar një mesatare prej 28.5 ditësh trajnimi/auditues, një nivel i lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite që nga krijimi i tij.

- Intensifikimit të bashkëpunimit me organizma dhe institucione homologe, si: Gjykatën Europiane të Audituesve (ECA), Zyrën e Auditimit Qeveritar të SHBA-së (GAO), Zyrën e Bashkimit Europian në Shqipëri, USAID-in, etj.

Kuvendi kërkon që KLSH-ja për vitin 2021 të vazhdojë punën në këto drejtime:

- Të rrisë numrin e auditimeve financiare, të përmirësojë cilësinë e tyre me opinione profesionale dhe të kualifikuara kontrolli, në plotësim të kërkesave të progresraportit të Komisionit Europian.

- Të krijojë një qasje të auditimeve të performancës drejt fushave me ndjeshmëri publike duke synuar që rezultatet e auditimit të 3E-ve të kenë ndikim direkt në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe menaxhimit të shëndoshë të financave publike.

- Të evidentojë fushat e pambuluara me auditim nga KLSH-ja në vite, si dhe të planifikojë veprimtarinë audituese të tyre për një qasje të pakufizuar dhe të pavarur në auditimin e institucioneve, organizatave që janë përdorues të fondeve publike.

- Të aplikojë praktikat më të mira të auditimit të teknologjisë së informacionit, në përputhje të plotë me standardet INTOSAI, të përditësojë informacionin e subjekteve të audituara dhe projekteve të rëndësishme të qeverisjes elektronike, duke mbajtur në konsideratë raportin kosto/përfitim të këtyre projekteve dhe sigurinë e këtyre sistemeve.

- Të përmirësojë cilësinë e raporteve të auditimit, si dhe të forcojë kapacitetet profesionale nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare të auditimit.

- Të angazhohet për hartimin e një memorandumi mirëkuptimi me Kuvendin, me qëllim referimin e gjetjeve të auditimit në funksion të kontrollit parlamentar dhe rritjes së llogaridhënies publike, në zbatim të rekomandimit të progresraportit të Komisionit Europian, kapitulli 32 “Kontrolli financiar”.

- Të rrisë transparencën duke mundësuar zhvillimin e një komunikimi interaktiv me qytetarin nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ku të publikohen vendimet dhe raportet e plota të auditimeve, sipas afateve të përcaktuara në ligj dhe të rekomanduara nga KE-ja.

Miratuar në datën 24.6.2021